



One Albania SHA

Adress: "Muhedin Llagami" St., "Square 21" Complex, Tirana, Albania

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certified: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 | NIPT: J61814094W

ANEKSI NR. 1 B

KUSHTET E VEÇANTA TË SHËRBIMEVE DHE TARIFAVE

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifat përkatëse të shërbimeve si dhe mënyra e tarifimit.

- Plani Tarifor OFFICENET ADVANCE

Plani OFFICENET ADVANCE	
Pajtimi Mujor	1,320 Lekë/Muaj
Internet	Pa Limit
Internet 4G/4G+	300 GB

Ne mënyre që klienti të përmirësoj shpejtesinë e internetit pasi të ketë konsumuar GB e vlefshme, të përfshira ne programin e përcaktuar më sipër, do t'i ofrohet mundësia e blerjes së paketave shtesë të internetit si më poshtë:

Çmimi i Paketës	GB e përfshira	Vlefshmëria
300 Lekë	20 GB	30 ditë
500 Lekë	50 GB	30 ditë

Shënime:

1. Të gjitha tarifat e mësipërme janë me TVSH të përfshirë.
2. GB e përfshira në program janë të vlefshme për një periudhë 1 mujore dhe nuk transferohen në muajt e ardhshëm.
3. Njësitë GB të mësipërme nuk janë të vlefshme për t'u përdorur në Roaming.
4. Përlllogaritja e konsumit të internetit do të bëhet cdo 100 KB.
5. Pas konsumimit të GB të përfshira në paketë, klientet do të vazhdojnë lundrimin në internet por me shpejtësi të kufizuar (256 kbps).
6. Paketat shtese të internetit do të kenë një vlefshmeri prej 30 ditësh.
7. Maksimumi i zonave të lejuara për OfficeNet është 5 zona. Aktivizimi i 2 zonave të para është falas, 3 zonat shtesë janë një pagesë prej 300 lekë/zonë
8. Plani OFFICENET do të ofrohet me kontratë pajtimi me kohëzgjatje 12 mujore dhe kontratë pajtimi me kohëzgjatje 24 mujore.
9. Pagesa fikse mujore dhe GB e përfshira për muajin e parë të aktivizimit do të jetë proporcionale me ditët e mbetura të muajit të aktivizimit të kontratës.
10. Pagesat fikse mujore në vijim do të aplikohen cdo datë 1 të muajit kalendarik. Në çdo faturë mujore të lëshuar në vijim, do të shfaqet vlera e pagesës mujore fikse, paketat shtese të aktivizuara në muajin e mëparshëm dhe pagesa për aktivizimin e zones shtesë në muajin e mëparshëm.
11. Kohëzgjatja minimale e kontratës është 12 muaj. Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit brenda afatit fillestar 12 mujor apo 24 mujor, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e tarifës mujore fikse për të gjithë muajt e mbetur deri në përfundimin e afatit të kontratës 12 mujore ose 24 mujore.
12. Në rastet kur pajtimtari ka përfituar nga një ofertë promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale, dhe vendos zgjidhje të parakohshme të kontratës, së bashku me detyrimet e përmendura më sipër duhet të paguaj edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
13. Për të përfituar nga ofertat promovionale të komunikuar nga ONE, pajtimtari duhet të shlyejë detyrimet sipas afatit të përcaktuar në faturë.
14. Në rast kur OfficeNet ofrohet i kombinuar me plane të tjera tarifore me kontratë, dhe pajtimtari përfiton zbritje në pajtimin mujor apo rritje të benefiteve të OfficeNet, përfitimet e OfficeNet nuk do të jenë me të vlefshme nëse pajtimtari do të shkepusë kontratën e planit tarifor të kombinuar me OfficeNet.
15. Të gjitha pajisjet e dhëna Pajtimtarit nga ONE për ofrimin e shërbimit të internetit, janë pronë e ONE dhe i jepen në përdorim Pajtimtarit për të gjithë kohëzgjatjen e shërbimit. Pajtimtari detyrohet që në rastin e zgjidhjes ose përfundimit të kontratës të pajtimit, t'i kthejë ONE këto pajisje në kuti së bashku me të gjithë aksesorët.
16. Pajtimtari merr përsipër:
 - a) të përdorë pajisjet vetëm për qëllimin që i janë dhënë në përdorim nga ONE, duke respektuar të gjitha kushtet e përdorimit të pajisjeve si dhe do të sigurojë që pajisjet të funksionojnë brenda kushteve teknike të kërkuara;
 - b) të ruajë pajisjet nga dëmtime të ndryshme që mund t'i ndodhin si pasojë e ndryshimeve në rrymën elektrike, nga dëmtime që mund t'i shkaktohen nga faktorë atmosferikë;
 - c) të ruajë pajisjet nga ndërhyrje të paautorizuara të personave të tretë;
 - d) si dhe kthejë pajisjen në kuti së bashku me të gjithë aksesorët, në të kundërt Pajtimtari do të konsiderohet përgjegjës për dëmet e mundshme dhe si penalitet, do të paguajë vlerën prej 6,000 lekë për këtë pajisje.